VENDIM
Nr.400, datë 8.4.2008

PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI TË MINISTRISË SË DREJTËSISË, TË PRONËS SË PALUAJTSHME TOKË/ARË NR.18, NË ZONËN KADASTRALE 3 205, K-34-75 (32C), NË FSHATIN RRANXA, KOMUNA BUSHAT, DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.68, DATË 28.1.2008 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM, TË KOMUNËS BUSHAT, TË QARKUT TË SHKODRËS"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 "Për pronat e paluajtshme të shtetit", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë dhe të Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Drejtësisë, të pronës së paluajtshme, tokë/arë, nr.18, në zonën kadastrale 3 205, K-34-75 (32C), në fshatin Rranxha, komuna Bushat, me sipërfaqe 8.24 ha.

2. Komunës Bushat i hiqet e drejta e përdorimit për pasurinë tokë arë, të përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi.

3. Në listën e inventarit të pronave të paluajtshme, që i bashkëlidhet vendimit nr.68, datë 28.1.2008 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që i transferohen, në pronësi ose në përdorim, komunës Bushat, të qarkut të Shkodrës", hiqet ajo pjesë e pasurisë, që me këtë vendim, i kalon në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Drejtësisë.

4. Ngarkohen Ministri i Drejtësisë, Ministri i Brendshëm dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha


Trushi
Trushi (Malsoret)
Trushi (Gjonrekaj)
Melgusha
Melgusha (Melgusha e Madhe)
Melgusha (Vela)
Bushati
Bushati (Malsoret)
161.8
248.0
fusha e Derragjatit
fusha e Mgnit
fusha e Dardhes
fusha Jake
fusha Lukane
ura e Zanes
stalla
elektrop.
shk.
Zeljanes


370/9
370/10
207/2
478/1
566/1
201/1
RRANXA
ZK 3205
206/1
206/2
206/3
206/4
206/5
206/6
208/1
208/2